

CIG

**COUNCIL FOR
INCLUSIVE
GOVERNANCE**

Zgjedhjet dhe Dialogu: Roli i Serbëve të Kosovës

Raport Aktivitetesh

Beograd, Prishtinë, tetor 2010

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

Nju Jork, 2010

Hyrje

Zgjedhjet e ardhshme parlamentare të Kosovës dhe dialogu i paralajmëruar mes Beogradit e Prishtinës do të përcaktojnë të ardhmen e komunitetit serb në Kosovë. Vendimi për të marrë pjesë ose për të injoruar zgjedhjet do të përcaktojë nëse serbët do të kenë përfaqësues të cilët në mënyrë legjitime do të përfaqësonin komunitetin serb në nivelin qendror apo do të kenë përfaqësues legjitimiteti i të cilëve do të bazohet në numër të vogël votash. Një përfaqësim i fuqishëm politik do të tërhiqte vëmendjen e vendimmarrësve në Prishtinë. Komuniteti serb në Kosovë do të jetë pika kryesore e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës. Serbët duhet ta kenë një listë të qartë të prioriteteve të cilat do të dëshironin të jenë pjesë e agjendës së dialogut. Përderisa ka ende kohë për përgatitjet rreth dialogut, një vendim rreth pjesëmarrjes në zgjedhje është mëse urgjent.

Pjesëmarrja në zgjedhje ka përparësitë dhe kufizimet e saj. Një pjesëmarrje e kënaqshme e serbëve do të sigurote përfaqësim të mjaftueshëm institucional dhe do të prodhonte udhëheqësi politike legjitime. Por, pjesëmarrja gjithashtu do t'i jepte mbështetje legjitimitetit të institucioneve të Kosovës dhe do bënte që disa ta barazpeshojnë atë me njohjen e pavarësisë së Kosovës. Në anën tjetër, bojkotimi i zgjedhjeve do të ishte në një linjë me politikën e mosnjohjes, por një pozicion i tillë i do t'i linte serbët jashtë institucioneve edhe për katër vitet e ardhshme. Tani që edhe vetë Beogradi dëshiron të bashkëpunojë me të njejtat institucione, bojkoti nga ana e serbëve të Kosovës, e sidomos i atyre që jetojnë në jug të lumit Ibër, është jopraktik dhe aspak efikas.

Për ndryshim nga serbët në veri, serbët në jug mbështeten në institucionet e Kosovës për shumë shërbime. Në këtë kontekst, për ndryshim nga serbët në veri, ata në jug pritet të votojnë në numër të kënaqshëm. Pjesëmarrja nga disa e bojkoti nga disa të tjerë do të thellonte ndasitë mes tyre, përpos nëse mbretëron mirëkuptimi për gjendjet e ndryshme politike në të cilat gjenden serbët në veri dhe jug. Por edhe vetë serbët në jug vazhdojnë të jenë të ndarë politikisht. Pak njerëz presin që ata të formojnë një koalicion të vetëm parazgjedhor për të bërë gara me një listë të përbashkët zgjedhore, dhe në këtë mënyrë të rrisin shansin për të fituar më shumë se dhjetë ulëset e rezervuara.

Për të pasur një dalje më të madhe në zgjedhje, thelbësore mbetet edhe përkrahja, mundësisht e drejtpërdrejt, e Beogradit. Një numër i partive politike serbe parlamentare përkrahin pjesëmarrjen, por partitë e mëdha e kundërshtojnë atë. Pozicionet e partive politike janë të rëndësishme, por vendimi i qeverisë serbe mbetet elementi vendimtar.

Dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës i paralajmëruar për pranverën e vitit 2011 do të mund t'i jepte fund pasigurisë politike që e përcjell komunitetin serb. Dialogu do të mund të definonte një kornizë afatgjate me pika specifike rreth aktivitetit politik të serbëve. Serbët e Kosovës presin të kenë përfaqësues si në delegacionin e Beogradit ashtu edhe në atë të Prishtinës. Se si do të funksiononte pjesëmarrja e zyrtarëve serbë në dy delegacione me qëllime të kundërta është çështje që do të adresohet nga serbët e Kosovës. Strategjia 'dy ekipe një platformë' do të mund ta shëndrronte atë që duket si barrë në aset të cmuar.

Këto përfundime janë nxjerrë nga një sërë aktivitete në dy tryeza të rumbullakta, një në

Beograd dhe një në Prishtinë, si dhe një diskutim politik i një grupi të vogël në Prishtinë, i organizuar nga Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG), një organizate ndërkombëtare joqeveritare me seli në Nju Jork, në tetor të vitit 2010. Në të morrën pjesë përfaqësues politik të serbëve të Kosovës, zyrtarë të parlamentit dhe qeverisë së Serbisë dhe anëtarë të shoqërisë civile të Serbisë. Këto aktivitete janë pjesë e programit për zhvillim politik të komunitetit serb në Kosovë, program ky i financuar nga granti i Departamentit Federal për Politikë të Jashtme të Zvicrës

Për të nxitur një debat të hapur, CIG nuk përmend emra të përvecëm të anëtarëve të diskutimit. dhe kërkon mirëkuptim nga ata, idetë e të cilëve nuk janë paraqitur plotësisht në këtë raport. Për këtë, CIG merr përgjegjësi të plotë. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në kapacitete personale në këto diskutime. Aktivitetet janë mbajtur pa praninë e mediave.

Pjesëmarrja në zgjedhje: A është përfitimi më i madh se cmimi?

Përfitimi nga pjesëmarrja në zgjedhje e tejkalon cmimin për serbët në jug por jo edhe për ata në veri. Shumica e serbëve në veri janë fuqishëm kundër çfarëdo bashkëpunimi apo inkuadrimit në institucionet e Kosovës. Kjo ndodh në rradhë të parë për shkak se, për ndryshim nga serbët e jugut të cilët jetojnë nëpër enklava të vogla dhe të rrethuar nga shqiptarët e të varur nga shërbimet e Prishtinës dhe komunitetit ndërkombëtar, serbët e veriut marrin të gjitha shërbimet e nevojshme nga institucionet lokale, të njohura si institucione paralele, si dhe nga Beogradi. Lidhjet e tyre me Prishtinën pothuajse nuk ekzistojnë fare. Si rrjedhojë, ata nuk kanë asnjë motiv për të vendosur marrëdhënie me Prishtinën. Së paku jo derisa statusi i ngrirë të mos shkrihet. Përpjekjet e Prishtinës për të vendosur kontrollin në veri janë penguar. Në këto rrethana, një numër i pjesëmarrësve në diskutim sygjerman që përpjekjet e faktorëve relevantë të fokusoheshin në akomodimin e serbëve në jug të vendit. Se cka do të ndodhë me veriun do të dihet vetëm pas arritjes së marrëveshjes politike mes Beogradit e Prishtinës.

Politika e serbëve të Kosovës, në pjesët ku është e mundur, duhet të institucionalizohet si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Kjo nuk është zgjidhja ideale por më e mira në këto rrethana. Kjo zgjidhje nuk do të vie sepse serbët e Kosovës janë bërë më të pranueshëm ndaj deklaratës së pavarësisë së Kosovës, por sepse ata besojnë se do të mund të bënin më shumë përbrenda institucioneve. Serbët kanë krijuar institucionet lokale dhe kanë treguar disa rezultate solide. Ata konsiderohen përfaqësues legjitim nga pjesa më e madhe e serbëve pasi që në disa raste kanë fituar më shumë vota edhe se institucionet paralele në zgjedhjet paralele të vitit 2008.

Megjithatë, përfaqësuesit serbë në nivelin qendror nuk mund gëzojnë legjitimitetin të tillë. Përderisa në zgjedhjet lokale dalja në votim ka qenë prej 25 për qind në Graçanicë e deri në 65 për qind në Partesh, dalja në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2007 ka qenë rreth 1 për qind. Tri vite më vonë, serbët kanë edhe një rast ta përsërisin bojkotin e vitit 2007 apo të votojnë në numër të madh për të zgjedhur përfaqësues legjitim. Rasti tjetër nuk do të vijë edhe për 4 vite. Vendimi nuk është i lehtë sepse ai do të ketë implikime si për serbët e Kosovës ashtu edhe për Beogradin.

Qëndrimi i Beogradit është qenësor për numrin e votuesve dhe për inkorporimin eventual të serbëve në institucionet e Kosovës. Pikëpamja e shumicës serbe, përfshirë politikanët e

Beogradit është se politika serbe rreth Kosovës do të duhej të ishte më pragmatike dhe të reflektonte realitetin që po ndryshon dita ditës. Ajo gjithashtu do të duhej të mbështetej në opinionet e serbëve të Kosovës. Kritikën e serbëve të Kosovës do të duhej të konsideroheshin si opinione qëllimmira dhe jo si sulme me qëllim të diskreditimit të politikës së Beogradit. Ekziston një mendim i përgjithshëm se qëndrimi i Beogradit ndaj institucioneve lokale të Kosovës ka ndryshuar. Tanimë Beogradi nuk i dënon ata që marrin pjesë në zgjedhjet dhe institucionet e Kosovës, duke e konsideruar atë si të drejtë demokratike të çdo individi. Shumë nga bashkëbiseduesit gjithashtu janë të kënaqur me faktin që politikanët serbë nga Kosova drejtojnë Ministrinë Serbe për Kosovë.

Serbët e Kosovës përkrahin plotësisht qëndrimin e Beogradit për mosnjohje por jo edhe atë për mosbashkëpunim. Ata janë të sigurtë se ekzistojnë modele që lejojnë bashkëpunim pa njohje. Njëri nga politikanët serbë të Kosovës tashmë një kohë të gjatë ka propozuar modelin e pranimit por mosnjohjes së institucioneve të Kosovës. Ky model mund të shërbejë si platformë e bashkëpunimit midis serbëve të Kosovës dhe institucioneve të Kosovës derisa të arrihet një zgjidhje për statusin mes Beogradit e Prishtinës. Kjo zgjidhje e përkohshme do të nënkuptonte pjesëmarrjen e serbëve në institucione, duke përfshirë policinë, gjykatat dhe administratën publike por jo edhe njohjen e deklaratës së pavarësisë së Kosovës. Për të formuluar një politikë të tillë, është i nevojshëm një debat i mirëfiltër mes të gjitha partive politike të Kosovës dhe Beogradit.

Njëri nga propozimet ka qenë krijimi i një forumi të qëndrueshëm të serbëve të Kosovës, duke përfshirë edhe serbët e veriut. Ky forum do t'i adresonte problemet kryesore sic janë zgjedhjet e ardhshme parlamentare, dialogu mes Beogradit e Prishtinës, dhe unifikimi politik i serbëve. Mungesa e bashkëpunimit të brendshëm i ka penguar serbët në krijimin e një platforme dhe strategjie të përbashkët për të fituar më shumë se sa dhjetë ulëset e rezervuara. Sipas planit të Ahtisaarit, në dy zgjedhjet parlamentare pas hyrjes në fuqi të kushtetutës së Kosovës, parlamenti i Kosovës do t'i ketë dhjetë ulëse për entitetet politike që përfaqësojnë komunitetin serb. Pas dy mandateve zgjedhore, ulëset e rezervuara shëndrrohen në ulëse të garantuara, ulëse këto për entitetet politike serbe në rast se numri i atyre të fituara në zgjedhje është më i vogël se dhjetë.

Një aleancë politike e serbëve të Kosovës e ngjajshme me Povratak (Kthimi) ose DOS në Serbi do të ishte mënyra më e mirë për të pasur përfaqësim solid. Dyert e një aleance të tillë do të ishin të hapura për të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë për interesat e serbëve të Kosovës, duke përfshirë edhe anëtarët e shoqërisë civile. Sipas disa bashkëbiseduesve, deri më tani, përpjekjet për të unifikuar forcat politike të serbëve të Kosovës në të shumtën e rasteve kanë dështuar për shkak të mosmarrëveshjeve personale ndërmjet udhëheqësve politik. Shumë prej tyre kanë shprehur dyshimin se një koalicion i tillë serb do të mund të krijohet në kohë për t'u regjistruar për zgjedhjet parlamentare.

Serbët e Kosovës përfaqësohen nga dy lloje të partive politike: degët e partive me seli në Beograd dhe parti e iniciativa me seli në Kosovë. Partitë me seli në Kosovë dhe disa nga ato të bazuara në Beograd, sikurse Lëvizja Serbe e Ripërtritjes, tentojnë të marrin pjesë në zgjedhje. Partitë politike me seli në Beograd e të cilat janë në koalicionin qeverisës si Partia Demokratike, G17 Plus, si dhe Partia Socialiste e Serbisë nuk janë edhe aq të vendosura në pozicionet e tyre, përderisa shumica e atyre në opozitë si Partia Progresive Serbe, Partia Demokratike e Serbisë

dhe Partia Radikale Serbe janë kundër çfarëdo bashkëpunimi me institucionet e Kosovës. Partia Liberale Demokratike, forcë kjo opozitare, është në favor të pjesëmarrjes në këto institucione.

Serbët e Kosovës poashtu përfaqësohen nga dy lloje të institucioneve lokale: institucionet paralele të përkrahura nga Beogradi dhe tjerat të mbështetura nga Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar. Institucionet paralele janë rezultat i zgjedhjeve serbe të vitit 2008. Një numër i serbëve të Kosovës, në retrospektivë, thonë se zgjedhjet serbe të vitit 2008 duket se kanë qenë një gabim, vecanërisht në jug ku institucionet paralele nuk mund të jenë funksionale për shkak të kufizimeve të vendosura nga Prishtina. Edhe pse ekziston mirëkuptim i gjërë në mesin e serbëve të Kosovës se institucionet paralele në jug duhet të shuhen dalëngadalë, një strategji se si të arrihet kjo nuk ekziston. Disa kishin thënë se as Beogradi nuk është i kënaqur me këto institucione dhe është duke kërkuar rrugëdalje, por zyrtarisht vazhdon me mbështetjen e nevojshme politike e financiare. Spekullohet se Beogradi nuk do të organizojë zgjedhje të ardhshme lokale në Kosovë, duke bërë kështu që mandati i institucioneve paralele të përfundojë.

Jo të gjitha partitë politike me seli në Beograd janë të kënaqura me politikën qeveritare karshi Kosovës. Derisa shumica e partive opozitare akuzojnë qeverinë për koncesione të shumta të bëra me komunitetin ndërkombëtar dhe Prishtinën, disa parti tjera, kryesisht të vogla, pranojnë se qeveria është duke bërë shumë pak për vendosjen e bashkëpunimit me institucionet e Kosovës dhe për përmirësimin e marrëdhënieve me komunitetin ndërkombëtar. “Beogradi nuk mund të sillët sikur nuk ka shqiptarë në Kosovë.”

Një ndryshim i politikës së Beogradit ndaj Kosovës nuk është larg mendsh. Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e cila bën thirrje për dialog të drejtpërdrejt me institucionet e Kosovës mbi çështje që nuk kanë të bëjnë me statusin është një hap i madh përpara. Gjithashtu, Beogradi më nuk i dënon ata të cilët marrin pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe, në fakt, duke mos thënë shumë, Beogradi u kishte lënë vetë serbëve të Kosovës të vendosin në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhjet e fundit lokale. Serbët e Kosovës do të duhej të ishin më aktiv dhe të shfrytëzojnë këtë mundësi si dhe t’i ndihmojnë Beogradit në formulimin e politikave përmes dhënies së ideve dhe inputeve të ndryshme. Njëri nga pjesëmarrësit në diskutim pranoi se në vitet e kaluara serbët kanë qenë pasiv, por për shkak se “Beogradi u kishte thënë të jenë të tilla, por tani ka shenja se beogradi dëshiron që ata të jenë aktiv.”

Poashtu, ka edhe të tillë të cilët thonë se serbët e Kosovës do të duhej të merrnin pjesë në zgjedhje, me ose pa mbështetjen e Beogradit, pasi që në cilindo rast, përfitimet janë më të mëdha se cmimi që duhet paguar. Serbët e Kosovës mund të akuzohen për njohjen e pavarësisë së Kosovës por do të përfitojnë fuqi reale politike e cila do ta ndryshojë mënyrën se si ata jetojnë. Përfshirja në procesin politik do ti jepte fund izolimit dhjetëvjeçar nëpër enklava dhe varësisë nga faktorët e jashtëm. Këto përfitime konkrete janë më të mëdha se sa çfarëdo akuze abstrakte. Në gjithë këtë ka dicka edhe për Beogradin. Beogradi do të lirohej nga obligimi i tanishëm për të siguruar fondet kryesore dhe për të menaxhuar politikën në një territor jashtë kontrollit të tij.

Ky grup i serbëve, përkrahës të pjesëmarrjes në zgjedhje edhe pa përkrahjen e Beogradit, beson se pjesëmarrja është instrument për të rifituar fuqinë politike të cilën e kanë pasur deri në vitin 2004, dhe në asnjë mënyrë aksion kundër Beogradit. “Serbët e Kosovës kthyen fuqinë e tyre politike duke marrë pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2009, të cilat krijuan kushtet për formimin e

institucioneve lokale.” Gjithashtu, lobimi i tyre për pjesëmarrje nuk duhet të paraqitet si sulm i drejtpërdrejt ndaj institucioneve paralele. “Ne nuk jemi kundër institucioneve paralele apo në favor të institucioneve Kosovare. Ne thjesht jemi në favor të institucioneve të cilat mund të funksionojnë.” Aktivitetet e institucioneve paralele në jug janë të kufizuara nga Prishtina. “Nëse institucionet paralele kanë nevojë për ndihmën e policisë, ajo nuk do i vie as nga Prishtina e as nga Beogradi. Prishtina nuk i njeh ndërsa Beogradi nuk ka qasje në territor.”

Megjithate, institucionet paralele në veri operojnë të papenguara. Deri më tani ato në mënyrë të suksesshme kanë penguar përpjekjet e Prishtinës për organizimin e zgjedhjeve dhe krijimin e institucioneve. Prishtina nuk ka qenë në gjendje të vendosë kurrfarë forme të kontrollit në veri. Bojkotimi i zgjedhjeve të ardhshme parlamentare nga serbët në veri është mëse e sigurt. Pjesëmarrja e pritur solide e serbëve të jugut dhe bojkoti nga serbët në veri medeomos do të ketë implikime jo vetëm për marrëdhëniet përbrenda serbëve por edhe në ato mes serbëve e shqiptarëve. Disa zyrtarë shqiptarë të Kosovës publikisht kanë theksuar se nuk përkrahin një zgjidhje të tillë, pasi që ajo si e tillë krijon kushtet për ndarje, një qëndrim ky mjaft i fuqishëm në mesin e serbëve në veri. Serbët në jug do të dëshironin që edhe serbët e veriut të merrnin pjesë në zgjedhje dhe së bashku ta përfaqësonin qëndrimin e përbashkët të komunitetit serb të Kosovës. “Ne duhet t’i zgjidhim problemet e veriut jo për shkak për shqiptarëve po për hir tonin.” Në këtë kontekst, një numër i madh i pjesëmarrësve në diskutim propozuan që Ministria Serbe për Kosovë do të duhej të hartonte një strategji për bashkimin e serbëve të Kosovës në “një entitet të vetëm politik.”

Serbët e Kosovës presin një politikë më përmbajtësore, pragmatike dhe të qartë nga ana e Beogradit. Mesazhi i paqartë i Beogradit se ata të cilët marrin pjesë nuk do të dënohen në lidhje me zgjedhjet lokale të 2009-ës, la shumë votues serbë në mëdyshje rreth asaj se a i përkrah apo jo Beogradi këto zgjedhje. Serbët e Kosovës dëshirojnë që Beogradi të përkrahë haptazi pjesëmarrjen dhe të ndihmojë në krijimin e një liste të vetme zgjedhore. Ata e kuptojnë pozitën delikate të Beogradit, ku mbështetja publike do të mund të interpretohej si njohje e pavarësisë së Kosovës, por megjithatë presin që Beogradi të konsultohet me ta rregullisht në lidhje me këto çështje. Në mungesë të një mesazhi të qartë publik, shumë prej tyre besojnë se një vendim i paqartë është më mirë se thirrja për bojkot.

Por ka edhe prej tyre që besojnë se politika e paqartë dhe klandestine nuk është politikë serioze për një shtet serioz. “Mesazhet e paqarta nuk e kanë fuqinë e qëndrimeve të qarta publike”. Sipas pjesëmarrësve, problemi nuk është edhe aq në atë se duke përkrahur pjesëmarrjen në zgjedhje Beogradi mund të akuzohet për njohje të pavarësisë së Kosovës, porse çfarë implikimesh një përkrahje e tillë mund të ketë për institucionet paralele. Një gjë e tillë do të dukej sikur Beogradi është duke mbështetur institucionet e Kosovës në dëm të institucioneve paralele serbe. Beogradi nuk mund të përkrah edhe pjesëmarrjen në zgjedhjet e Kosovës edhe institucionet paralele serbe. “Beogradi nuk mund të përkrah të dyja, pjesëmarrjen në zgjedhjet e Kosovës dhe institucionet paralele.” Partitë politike të serbëve të Kosovës megjithate nuk do të duhej të dekurajoheshin nga mungesa e përkrahjes së hapur të Beogradit. Ata do të duhej të fokusoheshin në atë se si dëshirojnë të duken përpjekjet e tyre afatgjata në Kosovë dhe të punojnë për përmbushjen e atij qëllimi. Partitë politike të Beogradit me degë në Kosovë gjithashtu do të duhej të ishin më pragmatike dhe të mos i përmbahen në mënyrë strikte programit dhe disiplinës partiake. “Dega e partisë në Nish dhe dega e partisë në Kosovë ballafaqohen me sfida të ndryshme, prandaj, atyre

u duhen mënyra të ndryshme të veprimit.”

Ekziston një mirëkuptim i gjërë se qëndrimi i Beogradit reth zgjedhjeve—vazhdimi i paqartësisë—nuk do të ndryshojë. Veriu do t’i bojkotojë zgjedhjet. Serbët në jug do të votojnë në numër të madh. Krijimi i një liste të përbashkët zgjedhore ka pak gjasa të ndodhë. Sfidë kryesore pas zgjedhjeve është konsolidimi i institucioneve serbe të cilat janë të pranueshme për Prishtinën, Beogradin, dhe komunitetin ndërkombëtar. Sfidë tjetër është njohja nga shumica serbe e udhëheqësisë politike që do të dalë nga zgjedhjet. “Kjo është arsyeja pse ata të cilët votojnë i japin legjitimitet zgjedhjeve po aq sa edhe ata të cilët kandidohen.”

Dialogu Beograd-Prishtinë: Si do të përfaqësohen serbët e Kosovës?

Dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës pritet të jetë i gjatë dhe i vështirë. Edhe pse zyrtarisht do të merret me çështje teknike, shume nga pjesëmarrësit në diskutim besojnë se ndarja e çështjeve teknike nga ato të statusit është e pamundur. “Dokumentet e udhëtimit dhe tabelat e regjistrimit të veturave janë çështje teknike por poashtu edhe çështje që lidhen me statusin.” Serbët e Kosovës do të jenë grupi më i prekur nga rezultati i dialogut. Në këtë kontekst, ata duhet të jenë involvuar në mënyrë aktive në diskutime dhe nëse paraqitet nevoja të jenë pjesë e të dy ekipeve, atij të Beogradit dhe atij të Prishtinës. Përfshirja në të dyja delegacionet do të mund të ishte një mundësi, më shumë se sa një barrë, për aq kohë sa “serbët e Kosovës nuk shfrytëzohen si dekorim.”

Më e rëndësishme se në cilin delegacion do të përfshiheshin serbët e Kosovës është platforma e përbashkët për t’u siguruar se interesat e serbëve të Kosovës nuk injorohen në këto diskutime. Edhe pse dialogu pashmangshëm do t’i adresonte interesat e serbëve të Kosovës, ekziston frika se interesat nacionale të Beogradit e Prishtinës do të mund të lënin nën hije interesat e komunitetit serb. Negociatat dyvjeçare të Vjenës shpesh përmenden si shembull se si çështjet e statusit mund të vijnë para interesave të komunitetit serb.

Çështjet e ndjeshme të së kaluarës së afërme, paragjykimet dhe stereotipet do të marrin një kohë dhe përpjekje të konsiderueshme në fillim të dialogut. Lajmi i mirë është se duke u pajtuar për fillimin e dialogut të drejtpërdrejt, të ndërprerë pas deklaratës së pavarësisë së Kosovës, Beogradi është pajtuar me faktin se shqiptarët e Kosovës janë pjesë e planit, ndërsa shqiptarët e Kosovës janë pajtuar me faktin se akomodimi i komunitetit serb të Kosovës është thelbësor për marrëdhënie stabile jo vetëm mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës por edhe mes Beogradit dhe Prishtinës. Disa zyrtarë serbë kanë ritheksuar se për ata Kosova është më shumë se vetëm jetesa e serbëve këtu. Në këtë rast interesi nacional është pika thelbësore.

Dialogu, nëse është i suksesshëm, do ta përmirësojë arsimin, shëndetësinë, punësimin dhe telekomunikimin. Serbët e Kosovës kanë institucione të arsimit dhe shëndetësisë të cilat janë të ndara nga Kosova dhe kryesisht janë të punësuar në institucione paralele. Një numër i serbëve janë të punësuar në administratën publike të Kosovës por gati asnjë në ndërmarrje publike dhe në sektorin privat. Telekomunikimi është bërë problem serioz pasi që Prishtina hoqi antenat e atyre që ajo i konsideron operatorë ilegalë, duke ndërprerë kështu shërbimet telefonike për serbët e jugut të cilët shfrytëzojnë kryesisht shërbimet e ofruara nga Serbia. Këto çështje duhet të priorizohen në dialog.

Beogradi do të duhej t'u jipte prioritet zgjidhjes së çështjeve urgjente të cilat kanë ndikim në jetën e serbëve në Kosovë. Mbrojtja dhe ruajtja e komunitetit serb nuk është vetëm interes i serbëve të Kosovës por është edhe interes nacional i Serbisë. Shkalla e prezencës së Serbisë në Kosovë varet nga shkalla e prezencës e serbëve të Kosovës. "Prezenca serbe në Kosovë është më e rëndësishme sesa preambula e kushtetutës së Serbisë e cila deklaron se Kosova është Serbi."

Disa propozime ishin për ate që dialogu do të duhej të ishte proces në dy shtigje: një në mes Beogradit e Prishtinës dhe tjetri mes serbëve të Kosovës dhe Prishtinës. Dialogu mes Beogradit e Prishtinës do të mbulonte çështje sic janë trashëgimia kulturore, dokumentet e udhëtimit, tabelat e regjistrimit të veturave, personat e zhdukur, transportin, bashkëpunimin policor, gjyqësinë, tregtinë e kështu me rradhë. Dialogu mes serbëve të Kosovës dhe Prishtinës do të kufizohej rreth çështjeve brenda Kosovës, sic janë hapja e një kanali televiziv në gjuhën serbe përbrenda Radiotelevizionit të Kosovës, konsolidimi i i komunave të reja me shumicë serbe, punësimi në administratën publike e kështu me rradhë.

Regjistrimi i popullsisë së Kosovës i planifikuar për pranverën e vitit 2011 është çështje e ndjeshme. Duke ditur se një numër i madh i refugjatëve serbë të Kosovës nuk kanë qenë në gjendje të kthehen në Kosovë, serbët frikësohen se regjistrimi do të legjitimojë pastrimin etnik të vitit 1999. Ky është regjistrimi i parë i popullsisë qysh nga viti 1981. Kjo është një çështje e cila urgjentisht duhet të adresohet dhe në të cilën serbët e Kosovës dhe Beogradi duhet të punojnë me Prishtinën dhe komunitetin ndërkombëtar për të gjetur mënyrën për regjistrimin e serbëve të Kosovës të cilët gjenden si refugjatë në Serbi.

Serbia duhet të definojë qartë qëllimet e dialogut me Prishtinën dhe këto qëllime nuk duhet medeomos të bëhen në debate publike. Beogradi duhet ta dijë se çfarë dëshiron të arrijë nga dialogu dhe në çfarë mënyre, si dhe të mënjanojë përsëritjen e gabimeve të negociatave të kaluara. Beogradi duhet të jete real në artikullimin e temave të cilat dëshiron t'i diskutojë dhe nuk duhet të bëjë listë dëshirash. Partneriteti me komunitetin ndërkombëtar, i cili sipas te gjitha gjasave do ta organizojë dhe ta ndërmjetësojë dialogun, është qenësor për Serbinë. Edhe pse dialogu nuk është aq urgjent, ekziston pajtimi në mesin e serbëve të Kosovës dhe zyrtarëve të Beogradit se procesi i definimit të çështjeve që do të diskutoheshin gjatë takimeve duhet të fillojë tani.

Përmbyllje

Zgjedhjet e hershme parlamentare të Kosovës nuk lënë shumë kohë që partitë politike të serbëve të Kosovës të zvogëlojnë ndryshimet mes vete, të formulojnë një platformë të përbashkët zgjedhore dhe të kandidojnë nën një listë të vetme elektorale. Megjithate, këto zgjedhje pritet të prodhojnë udhëheqësi legjitime për përfaqësimin e serbëve nëpër institucione. Legjitimiteti i zgjedhjeve varet kryekëput nga dalja e serbëve në votime. Serbët në jug pritet të votojnë në numër më të madh ndërsa ata në veri pritet ta bojkotojnë procesin. Pjesëmarrja solide e serbëve në zgjedhje dhe integrimi në insitucionet qendrore pashmangshëm do t'i jepte më shumë legjitimitet institucioneve të Kosovës, por gjithashtu do të forconte pozitën e serbëve në vendimmarrje, gjë kjo thelbësore për ruajtjen e komunitetin serb.

Dialogu mes Beogradit e Prishtinës ende nuk ka agjendë zyrtare. Përderisa Beogradi e Prishtina kanë përmendur disa tema që do të mund të përfshiheshin në diskutime, ende nuk është hartuar një listë zyrtarëve e këtyre çështjeve. Pa një agjendë zyrtare, është e vështirë të definohet roli i serbëve të Kosovës dhe modalitetet për angazhimin e tyre në dialog. Sipas të gjitha gjasave, serbët e Kosovës do të jenë pjesë e të dy delegacioneve. Ekzistojnë brenga rreth idesë që serbët të jenë pjesë e dy ekipeve me qëllime të kundërta. Pjesëmarrësit kanë konkluduar se dialogu së pari duhet të zgjidhë problemet ditore të serbëve të Kosovës e vetëm pastaj të adresojë çështjet më madhore.

Pjesëmarrësit

Sipas alfabetit të gjuhës angleze

Milos Andjic, Lëvizja Serbe e Ripërtrirjes, Beograd
Nenad Cvetkovic, Iniciativa qytetare Zavicaj, Partesh
Oliver Ivanovic, Ministria për Kosovë dhe Metohi, Qeveria e Serbisë
Dusan Janjic, Forumi për Marrëdhënie Etnike, Beograd
Vesna Jovanovic, Partia Social Demokrate, Partesh
Dragisa Krstovic, Partia Liberal Demokrate, Leposaviq
Petar Miletic, Partia e Pavarur Liberale, Mitrovicë
Bratislav Nikolic, Partia e Pavarur Liberale, Shtërpce
Dragan Nikolic, Radio Kompas, Gjilan
Randjel Nojkic, Lëvizja Serbe e Ripërtrirjes, Graqanicë
Veljko Odalovic, Partia Socialiste e Serbisë, Beograd
Zoran Ostojic, Partia Liberal Demokrate, Beograd
Vesna Pesic, Partia Liberal Demokrate, Beograd
Stojanka Petkovic, Partia G17 Plus, Mitrovicë
Dejan Radenkovic, Partia Socialiste e Serbisë, Prishtinë
Nenad Radosavljevic, Radio/TV Most, Leposaviq
Dragoljub Repanovic, Partia Radikale Serbe, Istog
Branko Ruzic, Partia Socialiste e Serbisë, Beograd
Mihailo Scepanovic, Parti Serbe e Popullit, Prishtinë
Vlajko Senic, Partia G17 Plus, Beograd
Predrag Simic, Universiteti i Beogradit, Departmenti i Shkencave Politike, Beograd
Bojan Stojanovic, Partia e Pavarur Liberale, Graqanicë
Momcilo Trajkovic, Lëvizja e Rezistencës Serbe, Graqanicë
Rada Trajkovic, Lëvizja Evropiane e Serbisë, Graqanicë
Danijela Vujcic, Partia G17 Plus, Mitrovicë
Didier Chassot, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrrës
Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse, Nju Jork
Marija Govedarica, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse, Beograd
Alex Grigorev, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse, Nju Jork
Caroline Tissot, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrrës